

VENDIM
Nr. 109, datë 18.9.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME MIRDITË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 18.9.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mirditë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Mirditë (UK Mirditë), me shkresën nr. 84 prot., datë 20.2.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor të UK Mirditë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) shoqëria UK Mirditë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 20 511 banorë në Bashkinë Mirditë, përveç njësive administrative Kaçinar dhe Selitë;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Mark Leka, zotëron diplomë në Inxhinieri Metalurgji marrë në maj të vitit 1983 dhe ka 36 vite përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mirditë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale; aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës; përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca; si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejitim të abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe të verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Mirditë, rekomandon se:

- shoqëria UK Mirditë duhet të përfshijë në zonën e shërbimit edhe njësitë administrative Kaçinar dhe Selitë, në zbatim të VKM-së nr. 63;

- shoqëria UK Mirditë duhet të aplikojë menjëherë pranë ERRU-së, për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me një strukturë të re tarifore.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mirditë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a., me NUIS: J69303012L, në kategoritë:

- a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor - z. Mark Leka;
- b) Drejtues teknik - z. Mark Leka.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a është: Bashkia Mirditë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime UK Mirditë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani